



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:045117  
Datë: 11.11.2024  
Numri i dokumentit: 06434774

CAP.nr.668/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Mevlide Kosumi Qarri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “ Prishtina” Sh.a, me adresë në rr. “Hazir Shala” nr.4 Prishtinë, kundër debitorit A. D. nga rr. “... “ nr., Lipjan, për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej 890.52 €, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, PPP.nr.15/2021, të datës 22.02.2023, me datë 11.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.a, me adresë në rr. “Hazir Shala” nr.4 Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, PPP.nr.15/2021, të datës 22.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.15/2021, të datës 22.02.2023, ka vendosur si në vijim: *“Aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit A. D. nga rr. “...” nr., Lipjan, për pjesën e kërkesës në të holla në shumë prej 851.59 €, dhe në këtë pjesë Anulohet urdhri i përmbartuesi privat D. B. nga Prishtina, P.nr.515/21 të datës 05.02.2021, ndërsa për pjesën tjetër në shumën prej 38.93€, Refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe urdhri i përmbartuesit privat për këtë pjesë mbetet në fuqi. Secila palë vetë i bartë shpenzimet e procedurës “.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, ashtu që aktvendimi i atakuar të anulohet për pikën I

dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallë së parë në rigjykim ose të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe të refuzojë prapësimin e debitorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitorit.

Gjykata e Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me nenin 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore(LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbartimit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” sh.a, në Prishtinë ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit të përmbartimit A.D. nga Lipjani, ndërsa përmbartuesi privat me urdhrin P.nr.515/2021 të datës 05.02.2021, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifër nr.1... për pagesën e borxhit në shumë prej 890.52€ të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Kundër urdhrin për përmbartim debitorit, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me arsyetimin se borxhi i debitorit është i vjetërsuar në pajtim të nenit 360 par.1 i LMD-së, me faktin se borxhi është krijuar për periudhën për vitin 2013 dhe 2021. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PP.nr.15/21, të datës 22.02.2023, e ka aprovuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbartimit për shumën prej 38.93€ në emër të borxhit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se gjatë vlerësimit të prapësimin del se borxhi i debitorit për periudhën prej viti 2013 deri më 2021, dhe se ky borxh deri më 29.11.2021 është parashkruar konform nenit 360 par.1, 2, 3 të LMD-së,

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar meqenëse kreditori e ka paraqitur propozimin për përmbartim për borxhin e krijuar nga viti 2013 e deri në vitin 2021, me datën 05.02.2021, e që kërkesat e kreditorit për vitet 2013 e deri në vitin 2020 në shumën prej 851.59 €, janë paraqitur pas afatit ligjor dhe si të tilla janë parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, ndërsa pas kësaj periudhe borxhi në shumën si në aktvendim nuk ka parashkrim.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të debitorit Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar parashkrimit të kërkesës, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se kërkesa për periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2020 është e parashkruar, kjo pasi që edhe vet kreditori në provat e bashkangjitura në propozim dhe përgjigjen në prapësim, i është referuar borxhit të debitorit brenda kësaj periudhe, ndërsa që propozimi është paraqitur me datën 05.02.2021 (pas kalimit të afatit një vjeçar).

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Kjo pasi që në bazë të shkresave të lëndës, shihet se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit përfshin periudhën prej datës 01.01.2013 deri me datë 29.01.2021, ndërsa nga shikimi i dokumentit përmbarimor – kartela financiare e konsumatorit, me numër 107489, shihet se borxhi periudhën prej 01.01.2013 deri në fillim të vitit 2020 është i parashkruar, pasi që borxhi i shpenzimeve të ujit është borxh i cili arrin pas përfundimit të çdo muaji, e po ashtu edhe parashkrimi rrjedh pas përfundimit të çdo muaji për secilin muaj në mënyrë të veçantë, ndërsa pas kësaj periudhe pavarësisht se gjykata e shkallës së parë është thirr në ndërprerjen e parashkrimit në shumën prej 38.93€, për të cilin nuk ka parashkrim (pasi që debitori ka bërë pagesa me datën 09.02.2020), ndërsa është dashur të arsyetohet me faktin e paraqitjes së propozimit të datës 05.02.2021 me të cilin veprim është ndërprerë parashkrimi. Me dispozitat e nenit 341 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Nr.04/L-077) parashihet se “Me parashkrim pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit”, ndërsa në par.3 të këtij neni parashihet se “Gjykata nuk mund ta merr parasysh parashkrimin në qoftë se debitori nuk thirret në të”. Në nenin 342 par.1 të këtij ligji parashihet se “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa me nenin 360 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “Parashkruhen për një vjet: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit, për shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake”. Në nenin 372 të LMD-së parashihet se: “për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se debitori është faturuar si biznes dhe te bizneset nuk vlen afati 1 vjeçar i parashkrimit, pasi që këto pretendime nuk i ka mbështet me asnjë provë, ngase propozimi nuk është paraqitur ndaj biznesit por ndaj personit fizik këtu debitorit A. D. e po ashtu edhe nga kartela financiare e konsumatorit nuk evidentohet emri i ndonjë biznesi. Po ashtu pretendimet ankimore se me pagesat e bëra ka pasur ndërprerje të parashkrimit nuk qëndrojnë, pasi që është vlerësim i Gjykatës së Apelit se pagesat e bëra janë bërë në mënyrë paushalle dhe nuk i përgjigjen pagesës së kësteve për konsumimin mujor, pasi që nuk është specifikuar se për cilën faturë është kryer ajo pagesë. Kjo bazuar në dispozitat e nenit 293 par.2 të LMD-së ku parashihet se “Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”. Andaj pasi që nuk ka pasur specifikim se për cilën faturë është kryer pagesa, dhe shumat e paguara nuk kanë korresponduar me shumën e asnjërës prej

faturave, konsiderohet se është paguar borxhi sipas faturave të para, andaj si të tilla nuk ndikojnë në ndërprerjen e parashkrimit.

Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208, 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.668/2023, datë 11.11.2024

G j y q t a r j a  
Mevlide Kosumi Qarri